

ENTI RREGULLATOR I UJIT



SHOQËRIA RAJONALE UK SARANDË

ANALIZA E HUMBJEVE TË UJIT PËR VITIN 2022

Tiranë, 2023

Bilanci i Ujit

Analiza e Humbjeve të Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Sarandë

I. Të Përgjithshme mbi Hartimin e Bilancit të Ujit

ERRU harton çdo vit Raportin e Bilancit të Ujit për shoqëritë që operojnë në Sektorin Ujësjiellës - Kanalizime. Ky raport merr një rëndësi të veçantë për një menaxhim racional të sektorit sepse trajton në mënyrë të veçantë treguesin e Ujit Pa të Ardhura, pra humbjet e ujit. Treguesi UPA lidhet ngushtësisht me cilësinë e shërbimeve që shoqëritë i ofrojnë konsumatorëve si edhe me qëndrueshmërinë financiare të tyre.

Organizimi i ri i shoqërive, në 15 shoqëri rajonale në sektorin UK, ka sjellë nevojën për një strukturim të ri të analizës mbi UPA dhe "Bilancin e Ujit" në tërësi. Analiza e humbjeve të ujit për çdo shoqëri rajonale kryhet duke analizuar fillimisht Bilancin e Ujit më vehte çdo njësi (ish shoqëri UK) që tashme është nën administrimin e shoqërisë rajonale të krijuar, dhe më pas analiza bëhet në mënyrë të integruar për shoqërinë rajonale në tërësi. Kjo qasje mundëson vënien në pah të problematikave individuale të çdo njësie të cilat duhet të kihen parasysh në të ardhmen për zgjidhjen, apo përmirësimin e tyre.

Kjo analize i vjen në ndihmë çdo shoqëri rajonale duke i mundësuar asaj që nëpërmjet analizës së komponentëve përbërës të Bilancit të Ujit, për çdo njësi dhe në tërësinë e shoqërisë rajonale, të njihet në mënyrë analitike me nivelin e humbjeve (UPA), të nën komponentëve të saj, arsyet e veçanta të nivelit të lartë të humbjeve të ujit, nevojën dhe mënyrën e monitorimit të humbjeve, problematikat e faturimit me matje dhe aforfe, si dhe rekomandimet që ERRU jep për çdo shoqëri UK për të realizuar përmirësimet e nevojshme në punën e tyre.

"Bilanci i Ujit" si një instrument mjaft i rëndësishëm në përmirësimin e treguesit kryesor të performancës UPA duhet të hartohet me të dhëna sa më të sakta pasi hapat që do të ndërmerren për reduktimin e tij lidhen ngushtësisht edhe me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë.

Si model i hartimit të Bilancit të Ujit do të përdoret ai i IWA (Shoqërisë Ndërkombëtare të Shoqërive të Ujësjiellësve).

Duke patur parasysh gjendjen teknike të sistemeve të furnizimit me ujë si mungesën e matësve në burim, mos organizim të rrjeteve shpërndarëse bazuar në konceptin e Zonave të Matje të Pavarura (DMA-të), mangësitë në mjetet dhe metodat e monitorimit të konsumit, është vendosur që si metodologji e llogaritjes së nën komponentëve të Bilancit të Ujit të përdoret ajo nga "lart-poshtë" (top-down), ku fokusi kryesor në llogaritjen e humbjeve totale është përcaktimi i humbjeve të dukshme, dhe më tej përcaktohen ato reale.

II. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Sarandë

Shoqëria rajonale UK Sarandë përbëhet nga ish shoqëritë UK ose Njësitë, përkatësisht UK Sarandë, UK Finiq, UK Delvinë dhe UK Konispol.

Të dhëna të përgjithshme, në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banor me dhe pa matje, në të gjithë zonën e shërbimit të Sh. R UK Sarandë jepen në **tabelën 1**.

Nga të dhënat e Tabelës 1, nuk konstatohen probleme të **nën faturimit** me matje në asnjë prej ish shoqërive që përbëjnë Sh. R Sarandë. Probleme me **faturimin aforfe** vërehen në të gjitha njësitë e Sh. R Sarandë. Njësitë Sarandë dhe Finiq, te cilat duhet të analizojnë arsyet përkatëse (nëse janë përfshirë ose jo klientët jo aktive), sepse referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992 faturimi duhet të jetë 150 litra/ditë për banorë. Konkretisht ish shoqëritë UK Konispol (244.1 litra/ditë për banorë) dhe Delvinë (218.9 litra/ditë për banorë) duhet të analizojnë me kujdes të dhënat mbi volumet e faturuara dhe numrin e klientëve të faturuar aforfe, për të gjetur dhe arsyet e këtij mbi faturimi.

Tabela Nr. 1 Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Shoqëria Rajonale Sarandë	UK	Popullsia e Shërbyer	Konsumi Total (në m3)	Konsumi i Matur (në m3)	Konsumi Pamatur (në m3)	Lidhjet me matës	Lidhjet pa matës	Konsumi (l/ditë, banor)		
								Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
Sarandë		29,073	1,250,000	1,206,000	44,000	17,296	968	120.0	78.2	117.8
Finiq		5,482	234,000	130,000	104,000	1688	1,003	103.6	139.4	116.9
Konispol		5,261	287,000	277,000	10,000	2,294	50	147.4	244.1	149.5
Delvinë		4,373	225,600	175,500	50,100	2,515	421	128.4	218.9	141.3
Shuma		44,189	1,996,600	1,788,500	208,100	23,793	2,442	122.3	138.6	123.8

Referuar gjithashtu tendencës së rritjes së vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në tabelën 2, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit për popullsinë e shërbyer jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre.

Tabela 2 Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh .R. Sarandë	Popullsia e Shërbyer	Uji i Prodhuar që futët në sistem (në m3)	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe (l/ditë, banor)	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij (në m3)	Sasia e Disponueshme e Ujit (l/ditë, banor)	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës (l/ditë, banor)
Sarandë	29,073	4,300,817	117.8	29073	7,095,600	669	+550.9
Finiq	5,482	949,000	116.9	12306	10,059,984	2,240	+2,122.7
Konispol	5,261	420,020	149.5	5261	3,122,064	1,626	+1,476.4
Delvinë	4,373	458,920	141.3	4815	6,820,000	3,881	+3,739.2
UK Sarandë (Rajonale)	44,189	6,128,757	123.8	51,455	27,097,648	1,443	+1,319

Nga tabela 2 shihet se shoqëria rajonale UK Sarandë ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit në të gjitha njësitë përbërëse, për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë më 24/7” për çdo njësi furnizimi.

II.1 UPA për Ish Shoqërinë UK Sarandë

Gjatë vitit 2022, ish shoqëria UK Sarandë ka prodhuar 4,300,817 m³ ujë prej cilës **100 % rezulton i matur**. Raportohen 20,908 lidhje uji ndërsa shërbimi i FU ofrohet për 100% të popullsisë në juridiksion. “UPA” rezulton në nivelin 48.60%. Rrjeti shpërndarës i FU është pjesërisht i organizuar në zona të pavarura me matje (DMA), për rrjedhje monitorimi i humbjeve nuk mund të bëhet i detajuar sipas DMA-ve, por në tërësi për të gjithë sistemin. Kjo gjendje vështirëson monitorimin efikas të humbjeve dhe njëkohësisht bëhet pengesë gjatë ndërtimit të strategjive për zvogëlimin e humbjeve me orientim prioriteti në DMA-të më problematike.

Në tabelën 3 paraqitet bilanci i ujit si dhe komponentët përbërës të tij për ish shoqërinë UK Sarandë .

Tabela 3. Bilancit i Ujit për Ish Shoqërinë Sarandë - Viti 2022.

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futët në sistem	4,300,817	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	2,166,651	50.38%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	44,173	1.03%
Faturimi Total	2,210,824	51.40%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	48,008	1.12%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	108,602	2.53%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	262,047	6.09%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	215,025	5.00%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	585,674	13.62%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	430,082	10.00%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	86,016	2.00%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapë derdhjet në depot e ujit	129,025	3.00%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	788,131	18.33%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësllësit	23,057	0.54%
Humbjet Reale (Teknike)	1,456,311	33.86%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	2,041,985	47.48%
UJI PA TË ARDHURA	2,089,993	48.60%

Komente :

- Treguesi i UPA në nivelin 48.60% konsiderohet mjaft i larta dhe i papranueshëm.
- Volumi i ujit të prodhuar raportohet i matur në nivelin (100%).
- Niveli i humbjeve reale në rrjetin e transmetimit (10%), konsiderohet mjaft i lartë. Për këtë shoqëria duhet të verifikojë evidencat e riparimeve të çarjeve nëse e justifikojnë këtë vlerë.
- 95.3% e klientëve faturohen me matje dhe pjesa tjetër aforfe.
- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në transmetim dhe shpërndarje në nivelin 8.62% të prodhimit vjetor konsiderohen të larta dhe që duhet verifikuar në terren mbi vërtetësinë e tyre.

Rekomandime:

- Në lidhje me përqindjen e lartë të mundshme të lidhjeve të paligjshme, Njësia duhet të ndër marrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve, që krahas verifikimeve në terren (task forcë) të krahasohet edhe me bazën e klientëve të OSHEE-se, si edhe me verifikime në vend për anash kalim të ujëmatësimit me lidhje dytësore.
- Për humbjet reale të larta në linjat e transmetimit dhe në shpërndarje, nëse janë probleme evidentë të gjendjes së keqe fizike të tyre, urgjentisht të planifikohen fonde nga qeveria qendrore ose me fondet e veta për riparimin e tyre.
- Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.

II.2 UPA për Ish Shoqërinë UK Finiq

Shërbimi i furnizimit me ujë në Njësinë Administrative Finiq ofrohet për 44.5 % të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor prej 949,000 m³ ujë, **raportohet 100% i vlerësuar** pasi mungonin matësimit në burim. Numri i lidhjeve me ujin raportohet 2.750 lidhje ku 63.4 % e tyre janë të pajisur me ujëmatës ndërsa pjesa tjetër faturohet aforfe. Faturimi rezulton në nivelin 26.09 % të prodhimit ndërsa **“Uji Pa të Ardhura” është në nivelin 73.91 %**. Monitorimi i humbjeve në rrjetin shpërndarës nuk bëhet në bazë të DMA-ve.

Në Tabelën 4 paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Finiq.

Tabela 4. Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Finiq – Viti 2022

Emërtimi	Viti 2022	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar që futët në sistem	949,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	143,210	15.09%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	104,410	11.00%
Faturimi Total	247,620	26.09%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	1,480	0.16%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	86,400	9.10%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	100,000	10.54%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	95,000	10.01%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	281,400	29.65%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	80,000	8.43%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	25,000	2.63%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapë derdhjet në depot e ujit	30,000	3.16%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	280,000	29.50%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit	3,500	0.37%
Humbjet Reale (Teknike)	418,500	44.10%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	699,900	73.75%
UJI PA TË ARDHURA	701,380	73.91%

Komente :

- Treguesi i UPA prej 73,91% rezulton në nivele të pakënaqshme dhe i papranueshëm.
- Pasaktësia e mundshme gjatë përlllogaritjes së sasisë së ujit të prodhuar me vlerësim, mund të jetë shkak kryesor i diferencës mjaft të madhe ndërmjet volumit të ujit të prodhuar ndaj atij të faturuar.
- Humbjet administrative në nivelin 29.65 % të prodhimit shkaktohen kryesisht nga lidhjet e paligjshme në rrjetet e transmetimit (9.10 %), shpërndarje (10.54 %) dhe nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim (10.01 %). Sidomos këto të fundit konsiderohen mjaft të larta dhe të papranueshme pasi kanë një impakt financiar negativ për shoqërinë.
- Humbjet teknike në nivelin 44.10 %, rezultojnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës (29.50%) dhe atë të transmetimit (8.43 %) dhe konsiderohen mjaft të larta dhe të papranueshme. Shoqëria duhet të analizojë situatën në terren për mundësinë e uljes së tyre.

Rekomandime:

- *Duke patur parasysh që prodhimi vlerësohet (100 %), është e domosdoshme dhe imediatë nevoja për investime në ujëmatës në prodhim. Shoqëria duhet të marrë masa urgjentë për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Në lidhje me përqindjen e lartë të lidhjeve të paligjshme, Njësia duhet të saktësojë bazën e klientëve, që krahas verifikimeve në terren (task-forcë) të krahasohet edhe me bazën e klientëve të OSHEE-së, si edhe me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësorë.*
- *Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.*

II.3 UPA për Ish Shoqërinë UK Konispol

Shërbimi i furnizimit me ujë në Nj. A. Konispol ofrohet për 100 % të popullsisë në juridiksion.

Prodhimi vjetor **raportohet 100% i vlerësuar** në sasinë 420,020 m³ ujë pasi mungojnë matësa në burime.

Faturimi rezulton 73.57 % e prodhimit, ndërsa **“Uji Pa të Ardhura” në nivelin 26.43 %.**

Ish shoqëria UK Konispol ka në administrim 2,440 lidhje uji, ku 98 % e tyre faturohen me matje. Monitorimi i humbjeve në rrjetin shpërndarës nuk bëhet në baze të DMA-ve.

Aktualisht formati i “Bilanci i Ujit” nuk është dorëzuar pranë ERRU-së. Të dhënat janë marrë nga Njësia e Monitorimit pranë ERRU-së dhe janë përpunuar nga Sektori Teknik bazuar në të dhënat e vitit paraardhës.

Në Tabelën 5 paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Konispol.

Tabela 5. Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Konispol – Viti 2022

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m3)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futët në sistem	420,020	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	299,000	71.19%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	10,000	2.38%
Faturimi Total	309,000	73.57%
Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar	200	0.05%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	1,680	0.40%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	3,000	0.71%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	4,700	1.12%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	9,380	2.23%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	24,000	5.71%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	1,200	0.29%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapë derdhjet në depot e ujit	1,100	0.26%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	74,040	17.63%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit	1,100	0.26%
Humbjet Reale (Teknike)	101,440	24.15%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	110,820	26.38%
UJI PA TË ARDHURA	111,020	26.43%

Komente :

- UPA rezulton në nivelin 26.43% të prodhimit vjetor dhe përfaqëson si nivel një nga treguesit më të mirë në sektor. Gjithsesi, vërtetësia e nivelit të UPA duhet justifikuar duke verifikuar në terren të dhënat, sidomos për mungesën e lidhjeve të paligjshme.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA), formati nuk është hartuar dhe dorëzuar për këtë vit, duke demonstruar se nevoja për trajnim të stafit teknik është evidente dhe e domosdoshme.
- Pasaktësia e mundshme në llogaritjen e sasisë së ujit të prodhuar 100% me vlerësim (jo me matje), vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit, mungesa e DMA-ve, e bën të diskutueshme vërtetësinë e vlerës së raportuar të volumit të ujit të prodhuar dhe të treguesit UPA.
- Humbjet teknike rezultuan në nivelin 24.15% të prodhimit vjetor, 17.63% e tyre humbasin në rrjetin shpërndarës dhe 5.71% në linjën e transmetimit.
- Konsumi total faturohet me matje në nivelin 73.57% ndërsa 86.6% e konsumatorëve janë të pajisur me matësa individuale duke përfaqësuar një nivel të mire të matjes.

Rekomandime:

- *Duke patur parasysh që asnjë burim furnizimi me ujë nuk është i pajisur me ujëmatës nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediatë, shoqëria duhet të*

marrë masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre, në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.

- Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjare me matës që ky tregues të jetë sa më afër nivelit 100%, që të bëjë të mundur minimizimin e humbjeve të dukshme nga lidhjet e paligjshme. Ndonëse këto humbje raportohen nivele të ultë nga shoqëria, besueshmëria e vlerave të tyre është e diskutueshme.
- Duke patur parasysh mangësitë dhe vështirësitë në raportimet e vlerave të Bilancit të ujit që ka demonstruar stafi i shoqërisë, është i domosdoshëm trajnimi i stafit si dhe caktimi i një personi përgjegjës për monitorimin e humbjeve, saktësimin e të dhënave si dhe hartimin e bilancit të ujit për gjatë gjithë muajve të vitit.
- Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.

II.4 UPA për Ish Shoqërinë UK Delvinë

Në Njësinë Administrative Delvinë shërbimi i furnizimit me ujë ofrohet për 90.8% të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor i vlerësuar raportohet në sasinë 458,920 m³ ujë.

Treguesi i UPA rezulton në nivelin 46.17 %. Konsumi i Autorizuar i Faturuar raportohet në nivelin 53.83 % ndërsa Konsumi i Autorizuar i pa Faturuar në nivelin 0.81 % e prodhimit.

Numri total i lidhjeve për shërbimin e FU raportohet 3,192 lidhje, nga të cilat 86.6 % faturohet me matje ndërsa 13,4 % e tyre aforfe. Lidhjet e paligjshme raportohen të pranishme 0.8 % në linjën e transmetimit dhe 1.29 % në rrjetin e shpërndarjes.

Në Tabelën 6 paraqitet Bilancit të Ujit dhe komponentët përbërës të tij për ish shoqërinë UK Konispol.

Tabela 6. Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Delvine – Viti 2022

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futët në sistem	458,920	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	196,010	42.71%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	51,040	11.12%
Faturimi Total	247,050	53.83%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	3,735	0.81%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	3,650	0.80%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	5,900	1.29%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	42,600	9.28%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	52,150	11.36%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	26,200	5.71%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	2,000	0.44%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapë derdhjet në depot e ujit	18,000	3.92%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	102,585	22.35%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit	7,200	1.57%
Humbjet Reale (Teknike)	155,985	33.99%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	208,135	45.35%
UJI PA TË ARDHURA	211,870	46.17%

Komente :

- Treguesi i UPA (46.17 %) rezulton në nivele të pakënaqshme.
- 97.9 % të konsumatorëve familjar faturohen me matje ndërsa pjesa e mbetur aforfe.
- Prodhimi vjetor nuk matët, por përcaktohet me vlerësim (100 %).
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA).
- Format i Bilancit të Ujit shpesh herë është plotësuar jo saktë dhe nevoja për trajnim të stafit teknik është evidente dhe e domosdoshme.
- Humbjet administrative janë 11.36 %, ku pjesën më të madhe e zënë “humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim” (9.28 %). Verifikimi i lidhjeve të paligjshme duhet kryer në terren pasi rezulton në nivele jo të besueshme.
- Humbjet teknike (33.99 %) shkaktohen nga rrjedhjet në rrjetin e transmetimit (5.71 %), në rrjetin shpërndarës (22.35 %) dhe nga rrjedhjet dhe kapë derdhjet në depot e ujit (3.92 %), që konsiderohen mjaft të larta. Shoqëria duhet të kryejë verifikimet në terren mbi rrjedhjet në rrjetin shpërndarës dhe gjendjen teknike të depove për të hartuar planet e veprimit për reduktimin e tyre.

Rekomandime:

- *Duke patur parasysh që asnjë burim furnizimi me ujë nuk është i pajisur me ujëmatës nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediatë. Shoqëria duhet të marrë masa urgjentë për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa me real.*
- *Shoqëria të rrisë përqindjen e konsumatorëve familjarë me matës që ky tregues të jetë sa më afër nivelit 100% për një faturim real të klientëve.*
- *Duke patur parasysh mangësitë dhe vështirësitë në raportimet e vlerave të Bilancit të ujit që ka demonstruar stafi i shoqërisë, është i domosdoshëm trajnimi i stafit si dhe caktimi i një personi përgjegjës për monitorimin e humbjeve, saktësimin e të dhënave si dhe hartimin e bilancit të ujit për gjatë gjithë muajve të vitit.*
- *Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.*

III Përmbledhëse e UPA për Shoqërinë Rajonale UK Sarandë

Shoqëria Rajonale UK Sarandë, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Sarandë, Konispol, Finiq dhe Delvinë, ka nën juridiksion 51,455 banorë. Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë realizohet vetëm për 44,189 banorë ose **85.9%** të popullsisë totale.

Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 29,290 lidhje, nga të cilat 26,826 lidhje ose **91.6%** janë të pajisur me aparate ujëmatës.

Prodhimi vjetor **6,128,757 m3 rezulton i matur në nivelin 70.2%**. Nevoja për aparateve ujëmatës në pikat prodhuese ku ato mungojnë është imediate.

Uji Pa të Ardhura rezulton në nivelin 50.81% të ujit që hyn në sistem, shoqëria faturon vetëm 3,014,494 m3 ujë ose 49,19% të prodhimit.

Tabela 7 paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2022, për Sh. Rajonale UK Sarandë.

Tabela 7. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Sarandë – Viti 2022

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m3)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futët në sistem	6,128,757	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	2,804,871	45.77%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	209,623	3.42%
Faturimi Total	3,014,494	49.19%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	53,423	0.87%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	200,332	3.27%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	370,947	6.05%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	357,325	5.83%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	928,604	15.15%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	560,282	9.14%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	114,216	1.86%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapë derdhjet në depot e ujit	178,125	2.91%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	1,244,756	20.31%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit	34,857	0.57%
Humbjet Reale (Teknike)	2,132,236	34.79%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	3,060,840	49.94%
UJI PA TË ARDHURA	3,114,263	50.81%

Komente :

- Treguesi UPA në nivelin 50.81 % të prodhimit vjetor, megjithëse nën mesataren e sektorit për të gjithë vendin konsiderohet i lartë dhe që duhet përmirësuar.
- Niveli i matjes për “Uji i Prodhuar”, në nivelin 70.2 % është i pranueshëm. Është e domosdoshme instalimi i martesave në të gjitha burimet e shfrytëzueshme.
- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarjes prej 6.05 % nuk konsiderohen të besueshme.
- Në humbjet teknike vlera prej 9.14 % të prodhimit vjetor nga rrjedhjet në linjat e transmetimit konsiderohet mjaft e lartë prandaj duhen dhënë argumenta të mëtëjshëm për justifikimin e tyre.
- Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes zënë pjesën më të lartë të humbjeve teknike prej 20.31% dhe konsiderohen mjaft të larta.

- Konsumatorët familjare me matje përbëjnë rreth 81.2% të numrit total të konsumatorëve, që për një menaxhim korrekt të kërkesës për ujë kërkohet të jetë sa më afër nivelit 100% të matjes.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.
- Në përgjithësi stafi i shoqërisë ka mjaft vështirësi për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit për çdo njësi të shoqërisë rajonale, nevoja për trajnim të stafit është e domosdoshme.

Rekomandime:

- *Të bëhen përpjekje për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë që mundëson një monitorim, diagnostikim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*
- *Të trajnojë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, si dhe të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit për çdo DMA dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale.*
- *Duke patur parasysh që disa prej burimeve të furnizimit me ujë nuk janë të pajisur me ujëmatës, nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate. Shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa me real.*
- *Shoqëria duhet të gjeje fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjare me matës që ky tregues të jetë sa më afër nivelit 100%, për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, me prioritet instalimin e matësve në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale.*
- *Në lidhje me përqindjen e lartë të mundshme të lidhjeve të paligjshme në ndonjë njësi të veçantë, shoqëria duhet të ndër marrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve bazuar edhe në bazën e klientëve të OSHEE-së.*
- *Të ngrihet një Task Forcë e cila vazhdimisht në bashkëpunim me degën e shitjes, të jetë në veprim në terren me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësore apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, si kontroll i punës së lexuesve të matësve dhe në përgjithësi për evidentimin e problematikes me ujin e nën faturuar.*
- *Të krijojë dhe të mirëmbajë të gjitha sistemet e informacionit, për të patur raportim të saktë dhe të besueshëm të të dhënave të kërkuara, në lidhje me bilancin e ujit dhe çdo informacioni tjetër që mund të kërkohet.*
- *Për korrigjimin e normave të faturimit me matje, shoqëria duhet të angazhohet në gjetjen e lidhjeve dyfishe.*
- *Për çdo lidhje pa matës, në pamundësi për vendosjen e matësit, nëpërmjet faturuesve duhet të verifikohet numri i banorëve (certifikatë familjare) për çdo lidhje dhe më pas të faturohen sipas VKM nr.102, datë 16.03.1992.*

- *Problematika në disa raste nuk është e njëjtë për çdo njësi. Për këtë duhet ti referohet problematikës në bilancin përkatës të çdo njësie të veçantë.*
- *Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohë pranë ERRU-së. Bilanci i ujit duhet të dorëzohet çdo 6 muaj, vërtetësia dhe saktësia e të dhënave të bilancit do të vlerësohet nga ERRU si penalitet ose bonus për shoqërinë raportuese.*